



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI

Ekstrakt

nga procesverbali i mbajtur më 2 korrik 2014, në mbledhjen e VI-të (gjashtë) të Kuvendit.

Mbledhja filloi në orën 13:05 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z. Mehmet Gashi, Kryesuesi Kuvendit.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Në mbledhje ishin të pranishëm z. Agim Kikaj, Nënkryetarë i Komunës, drejtorët e Drejtorive komunale, z. Muharrem Haziri përfaqësues i OSBE-së, disa përfaqësues të mjeteve të informimit dhe një numër i qytetarëve.

1. Miratimi i rendit të ditës

z. Kadri Avdiu, theksoi, rreth propozimit të rendit të ditës në si Grup i këshilltarëve nga radhët e Partisë Demokratike të Kosovës kemi vërejtje për mos përfshirje në rend dite çështja e Lagjes së Dëshmorëve, e që ka të bëjë me vonesa në rregullimin e infrastrukturës së asaj Lagjeje, si dhe mos përfshirja e një informate se çka është bërë deri më tani rreth çështjes së Obeliskut Afrim Zhitia.

z. Haki Rudari, theksoi, dy çështjet të cilat një ditë më parë i kam ngritur në Komitetin për Politikë dhe Financa, e të cilat nuk kaluan dua që t'i ngriti edhe sot në këtë mbledhje. Çështja e parë ka të bëjë me bujqësinë ku në mbledhjen e fundit të Kuvendit kam kërkuar nga drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që të kemi një informatë apo raport rreth bujqësisë dhe subvencioneve në bujqësi, unë realisht kam marrë një përgjigje jo të detajuar nga drejtori përkatës edhe pse nuk ka qenë kërkesë që vetëm unë të shoh por ka qenë kërkesë që ne si Kuvend i Komunës të debatojmë rreth bujqësisë. Çështja e dytë ka qenë Lagja e Dëshmorëve, dhe para se të vije deri te kjo temë, zotëri Kryesues i Kuvendit më datën më 19.06.2014 ka qenë Dita e Çlirimit të Komunës së Podujevës me ç'rast ne kemi mbajtur një mbledhje solemne të cilën ne si Grup i Këshilltarëve e kemi përshëndetur dhe kemi marrë pjesë në atë mbledhje por edhe unë si përfaqësues i Grupit të LVV-së kam marrë pjesë edhe në homazhet që kemi bërë në disa varreza, por çështja që dua të ngris si shqetësim, vërejtje apo edhe si propozim është se në atë mbledhje ka munguar himni Kombëtarë gjë që unë mendoj se atë ditë dhe në ato festa ku festohet Dita e Çlirimit por edhe që këtu kemi persona dhe bashkëlloftëtarë të luftës së fundit, ka qenë e udhës që fillimisht të kërkohet që të jetë himni Kombëtarë e pastaj për këtë tjetrin vendosni ju vetë, por ka qenë edhe mungesë e Flamurit Kombëtarë në atë mbledhje solemne gjë për të cilat mendoj që Drejtoritë përkatëse duhet t'i marrin për bazë këto për arsye se kemi të bëjmë me një Ditë të Çlirimit ku ka kontribuar i tërë populli.

Lidhur me çështjen e dytë rreth Lagjes së Dëshmorëve dëshiroj t'iu njoftoj se më datë 30.06.2014 në orën 15:00 Grupi i këshilltarëve nga LVV së bashku me kryesinë e lëvizjes kemi vizituar atë Lagje dhe jam tejet i befasuar për gjendjen e keqe në atë Lagje, gjë për të cilën nuk do të besojë po të mos e vizitoja, ku në këtë kohë dhe në këtë muaj të shenjët të Ramazanit ajo Lagje të jetë pa ujë kjo sipas meje nuk është në rregull, kam vizituar edhe familje brenda ku nuk ka pasur pikë uji dhe ka qenë shumë papastërti e madhe, andaj kërkoj nga ju kolegë të Kuvendit dhe nga Ekzekutivi që të keni parasysh këtë si dhe propozoj që sot në këtë mbledhje në mënyrë emergjente të diskutohet për situatën dhe gjendjen faktike në Lagjen e Dëshmorëve, dhe dëshiroj të keni për bazë sepse kemi të bëjmë me një gjendje shumë të rëndë. Gjithashtu një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa kam qenë i vetmi që kam votuar kundër rendit të ditës sepse kam kërkuar që në rend dite të përfshihet edhe kërkesa e Shoqatave të dalura nga lufta, pra në këtë rast unë foli krejt ndryshe sepse jam edhe anëtar i komisionit për ndarjen e atyre shtëpive, ne si komision vetëm një mbledhje e kemi mbajtur, nuk jemi ftuar më asnjëherë dhe çdo material që kemi kërkuar nuk na është dhënë, unë fillimisht kam kërkuar Memorandumin e nënshkruar në mes të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Podujevës, i cili nuk më është ofruar pastaj kam kërkuar gjendjen faktike të Lagjes së Dëshmorëve, numri i anëtarëve të familjeve nuk më është ofruar, me përjashtim të ditës së djeshme ku drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale pas mbledhjes së KPF-së më ka dhënë.

Dëshiroj që të keni parasysh këtë çështje dhe të deklarohen përfaqësuesit e Grupeve të këshilltarëve rreth këtyre dy pikave të cilat i ngrita.

z. Naim Çunaku, theksoi, më bëri të marr fjalën parafolësi z. Rudari i cili në një formë e ceku apo deshëm ta reprizojmë edhe një herë para Kuvendit mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, konkretisht fjala është rreth miratimit të rendit të ditës në atë mbledhje të KPF-së ku më ra pakë sa jo ndjejnë e mirë kur e atribuoj se vetëm ai ka qenë kundër miratimit të rendit të ditës, pa dashur të ju lodhi dhe duke mos u mundur të jap arsye time sepse jemi duke diskutuar për rend dite të kësaj mbledhjeje, mirëpo më duhet të sqaroj se një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa para dhjetë këshilltarëve janë propozuar pikat shtesë të rendit të ditës ku në një formë kemi ardhur në konkluzion të gjithë, 9 anëtarë, duke përjashtuar z. Haki Rudarin i cili e tha se ka qenë kundër, që në pikën të ndryshme t'i paraqesim dhe të marrim vendim për të gjitha ato propozime të cilat kanë qenë pika shtesë që ne i kemi propozuar. Pra mbase po duhet të bëhet transparente këtu para Kuvendit puna e Komitetit për Politikë dhe Financa, këtë po mundohem të bëjë, ka qenë propozimi që të futet në rend dite si pikë e veçantë e rendit të ditës gjegjësisht është ftuar Komiteti për Politikë dhe Financa që të merr vendim për çështjen e Komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës, komision i ngritur nga ky Kuvend, propozimi tjetër ka qenë të mbështet financiarisht apo të ndihmohet nga kategoria e subvencioneve kolegu ynë këshilltari gjegjësisht shefi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e LDK-së z. Islam Revuçi, dhe ka qenë kërkesë që të futet si pikë e rendit të ditës raporti i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, i cili mungon që mbase një vit, dhe që është arsyetuar për këtë mungesë, si dhe ka qenë propozim i shefit të Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së z. Kadri Avdiu çështja e zgjidhjes së problemit që është krijuar në Lagjen e Dëshmorëve gjegjësisht është bërë përrurimi apo inaugurimi i atyre shtëpive dhe sot e kësaj dite, duke e mbështetur atë që e

tha parafolësi z. Rudari që në atë Lagje është një situatë e vështirë kur kemi parasysh që se në qfatrë gjendje janë ata kontinjerë, vapën, mungesën e ujit etj, ndërsa në tjetrën anë kemi shtëpitë e përfunduara. Të gjitha këto por edhe tjera çështje i kemi shqyrtuar një nga një dhe janë dhënë arsyetimet prej drejtorëve të Drejtorive, dhe krejt në fund me shumicë të votave nuk është kualifikuar asnjë prej tyre që të jetë si pikë e veçantë e rendit të ditës dhe t'i rekomandohet Kuvendit për këtë mbledhje. Pra vetëm deshta, jo në detaje, ta përshkruaj mbledhjen e KPF-së.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, për momentin se di saktësisht që sa ky Kuvend ka ngritur Komisionin për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës, komision i cili deri më tani ka bërë një punë mjaft voluminoze por nuk është përcaktuar ndonjë kosto të këtij projekti i cili po na del më i madh se që kemi menduar. Në këtë fazë që jemi, kujtoj se puna e komisionit është duke ardhur në pikëpyetje dhe dyshoj se nuk do të mund të vazhdoj kështu të funksionoj dhe ta kryej punën e vetë, prandaj propozoj që të jetë një pikë e veçantë e rendit të ditës ku do të diskutohet për krijimin e kushteve për punë të këtij komisioni.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, rreth rendit të ditës për këtë mbledhje kam një propozim, që Kompanisë regjionale për menaxhimin e mbeturinave "Pastrimi" e cila ka pasur kontratë për mirëmbajtjen e mbeturinave në hapësirën turistike në Liqenit të Batllavës në bazë të një Vendimi të Kuvendit të mëparshëm e që tani ajo kontratë ka skaduar, t'i vazhdohet edhe për një vit me të njëjtën mënyrë ajo kontratë, pra këtë e propozoj duke marr për bazë edhe vërshimet e qytetarëve të shumtë nga Komuna të ndryshme të Kosovës gjatë këtij sezoni verorë në atë hapësirë turistike.

z. Haki Rudari, theksoi, e kam thënë dhe po e përsërisë prapë se kam besim në këtë përbërje të Kuvendit sepse konsideroj se aty ku ka debate besoj se ka edhe rezultate pozitive dhe se mendoj dhe besoj se debatit nuk duhet t'i shmanget askush ngase nga debatet nxirret vlera, mirëpo ajo çka kolegu z. Naim Çunaku e tha rreth mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa, unë them se nuk ka qenë kohë e largët por ka qenë një ditë më parë dhe se ekziston procesverbali i mbajtur në atë mbledhje se si është votuar, po të kishte kaluar propozimi i cekur dje, sot nuk do të kishte nevojë fare të kërkohej nga shefi i Grupit të këshilltarëve të PDK-së, ndërsa unë edhe një ditë më parë në mbledhjen e KPF-së por edhe sot në këtë mbledhje po kërkoj zotëri Kryesues sepse është e drejtë e imja si këshilltarë i Kuvendit të propozoj që të vohet në vota, që kjo përbërje dhe këta kolegë këshilltarë të respektojnë a dëshirojnë të debatojnë për gjendjen e rëndë në Lagjen e Dëshmorëve. Unë edhe në KPF kam thënë se nëse nuk i besohet kësaj që unë them, mund të formojmë një komision dhe të vizitojmë atë lagje.

Prandaj propozimi im është që të futet në rend dite situata në Lagjen e Dëshmorëve, dhe krahas kësaj pastaj mund të debatojmë edhe për shpërndarjen e atyre shtëpive dhe për pikën apo kërkesën e Shoqatave të dalura nga lufta, kërkesë të cilën e posedoj këtu dhe e cila u është dërguar të gjitha Grupeve të këshilltarëve, pra kërkoj që të vohet në votim.

z. Naim Çunaku, theksoi, sa për sqarim të Kuvendit, jam në dijeni se është procesverbali dhe po mundohem të them shumë decitivisht atë që ka ndodhur në Komitetin për Politikë dhe Financa, e thash edhe në fillim që të gjitha Grupet e këshilltarëve të Kuvendit e kanë marrë nga një shkresë prej Shoqatave të dalura nga lufta dhe që në fillim të mbledhjes është insistuar dhe është iniciuar së pari nga shefi i Grupit të këshilltarëve nga radhët e

PDK-së z. Kadri Avdiu që kjo të hyjë si pikë e rendit të ditës gjegjësisht që ai Komiteti t'i sugjeroj Kuvendit që për seancën e sotme të debatohet për problemet në Lagjen e Dëshmorëve, andaj këtu nuk kemi dilema zotëri Haki Rudari sepse kjo ka qenë kështu, ndërsa në fund të mbledhjes gjatë debatit është kërkuar njoftim prej Drejtorive përkatëse për gjendjen e asaj lagjeje, dhe na është thënë që vendosim në pikën, të ndryshme, për këtë çështje. E thash edhe më parë se në pikën, të ndryshme, nuk ka kaluar ky propozim që për këtë mbledhje t'i sugjerohet Kuvendit për përfshirje të kësaj pike në rend të ditës, propozimi që këshilltari e bëri është shumë legjitim, i arsyeshëm dhe i drejtë, propozim të cilin e kam mbështetur edhe në KPF e po ashtu e mbështes edhe sot, mirëpo në fillim pati një keqkuptim e që u nënkuptua se vetëm z. Haki Rudari ishte kundër ndërsa ne të gjithë të tjerët ishim për që mos hyjë kjo pikë në rend dite.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me rendin e ditës na u paraqiten disa kërkesa, është e vërtetë ajo që e tha parafolësi z. Naim Çunaku, ne në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa këto pika të cilat u përmenden deri më tani, me përjashtim të propozimit që e bëri drejtori z. Durim Salihu, të gjitha i kemi shqyrtuar në KPF përkatësisht në pikën, të ndryshme, dhe se për shkak se nuk kemi të përgatitur material apo informatë të kompletuar, nuk kemi mundur të debatohet për këto pika, por mundemi vetëm të kemi një informim të shkurtër, kështu që për këtë informim për të gjitha ato pika, nëse pajtoheni ne sot mund t'i diskutojmë në pikën, të ndryshme, meqë informimi që u bë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa ishte shumë i qartë për të gjithë anëtarët e këtij Komiteti.

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, ne në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi debatuar këtë çështje në mënyrë shumë korrekte, pavarësisht se a dëshironi apo jo të jetë kjo pikë e përfshirë në rend dite për këtë mbledhje, kërkesën e Shoqatave të dalura nga lufta për të cilën konsideroj se është shumë e arsyeshme, ne e kemi sqaruar se meqë ka qenë në procedurë të prokurimit dhe këtë e kemi dëshmuar edhe me dokumentacion, për ata edhe nuk ka kaluar me vota në KPF për të hyrë si pikë e veçantë në këtë mbledhje, mirëpo të gjithë ju duhet të jeni në dijeni se të gjitha obligimet që i ka marr Komuna për infrastrukturën përcjellëse, janë në procedurë të prokurimit, ka disa vonesa për shkak të projekteve zbatuese që fillimisht ka qenë projekti për 130 shtëpi, ndërsa është ndryshuar dhe tani kemi vetëm për 30 shtëpi, megjithatë me datën 14 të këtij muaji do të bëhet hapja e procedurave, dhe për këtë konsideroj se anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, dje kanë pasur mirëkuptim dhe nuk e kanë futur si pikë të veçantë për këtë mbledhje, pra mos të ketë dilema këtu në aspektin se ka dashur apo nuk ka dashur ndokush të futë në rend dite këtë çështje, mirëpo prapë është e juaja si këshilltarë të Kuvendit të vendosni për këtë, ne prapë mund t'i japim disa sqarime teknike, por esenca është që kjo çështje është në procedurë dhe për këtë nuk i është rekomanduar Kuvendit që kjo pikë të përfshihet në rend dite për këtë mbledhje.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, tani kemi tri apo katër çështje të cilat u ngritën dhe kemi disa dilema këtu, por nëse pajtoheni ne mund t'i lëmë këto çështje dhe të kërkojmë informata për këto në pikën të ndryshme, ngase nuk mundemi të debatohet për këto pika, gjithashtu kemi edhe çështjen rreth kompensimit të komisionit për emërtimin e rrugëve të cilën e ngriti z. Lutfi Rexhepi, por edhe propozimin e drejtorit z. Durim Salihu, për vazhdimin e dhënies në mirëmbajtje edhe për një vit të hapësirës turistike në liqenin e Batllavës.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, konsideroj se këto çështje që u paraqitën deri më tani është mirë t'i diskutojmë dhe të kemi për të gjitha nga një informatë në pikën, të ndryshme në kuadër të rendit të propozuar të ditës.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, atëherë unë propozoj që rendi i ditës të cilin e keni në material të plotësohet me një pikë me radhë përkatësisht me propozimin e z. Durim Salihut, drejtor i DPUMM, për vazhdimin e vendimit edhe për një vit të dhënies në mirëmbajtje të hapësirës turistike në Liqenin e Batllavës, dhe lus shërbimin e Kuvendit që të shpërndaj materialin këshilltarëve të Kuvendit, si dhe në pikën, të ndryshme, çështjet të cilat u theksuan, meqë kanë të bëjnë më shumë me një informatë të shkurtë. Andaj nëse pajtoheni me këtë që e thash, unë mund të vej në votim.

z. Bahri Selimi, theksoi, u debatua shumë rreth çështjes që ka të bëjë me Lagjen e Dëshmorëve dhe kërkesa e Grupit të këshilltarëve të LVV-së ishte shumë e qartë, me të cilën kërkuam që kjo të futet si pikë e veçantë në kuadër të rendit të ditës, prandaj duke u bazuar në të drejtat që ne i kemi, kërkojmë që të hedhet në votim apo t'i nënshtrohet procedurës së votimit propozimi apo kërkesa jonë në mënyrë që të jetë pikë e rendit të ditës dhe të debatohet për këtë çështje që ka të bëjë me Lagjen e Dëshmorëve.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, dua që t'ju sugjeroj që sa i përket asaj që kjo pikë të cilën e propozoj edhe parafolësi të futet në rend dite për këtë mbledhje, pasi që është politizuar mjaft dhe duke menduar partitë politike që t'i politizojnë Dëshmorët, në të ardhmen do të shohim se efekti i kësaj çështjeje do të jetë negativ për fajin e partive politike të cilat e shtinë në plan apo rend dite pa qenë të përgatitur, pra të hedhet në votim dhe të votojmë të gjithë për çështjen që ka të bëjë me Lagjen e Dëshmorëve në mënyrë që kjo çështje të jetë si pikë e veçantë e rendit të ditës për këtë mbledhje.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit e kam një propozim për ato çështje të cilat kërkohet të futen në rend dite. Për ato pika në, të ndryshme, do të kemi informatë por nëse është e nevojshme për mbledhjen e ardhshme e obligojmë Ekzekutivin e Komunës që të përgatit një informatë, e them këtë ngase pa pasur ne si Kuvend një informatë nga bartësit e Drejtorive përkatëse nuk mund të kemi debate ngase nuk jemi aq sa duhet të përgatitur, kështu që unë i propozoj Kuvendit që ta miratojmë rendin e propozuar të ditës me këto plotësime:

-Propozimi për vazhdimin e dhënies në mirëmbajtje edhe për një vit të hapësirës turistike në liqenin e Batllavës, dhe në pikën, të ndryshme në kuadër të rendit të propozuar të ditës të përfshihen të gjitha këto pika që u theksuan dhe të kemi informatë për këto pika.

z. Kadri Avdiu, theksoi, kjo çështje gati mori edhe karakter partiak, realisht atë që e tha z. Nexhat Llumnica, pa dashur të polemizoj dua të them se nuk mendoj se ka ndokush këtu qëllime partiake, por kush do që dëshiron të thirret në emër të familjeve të Dëshmorëve le ta bëjë atë, kurse unë personalisht jam këshilltar i Kuvendit dhe dëshiroj të mbroj atë që më është dërguar në formë të shkruar, me nënshkrime dhe me vulë nga një institucion zyrtar që unë e konsideroj ashtu sepse janë organizata në kuadër të degës, gjë të cilën e kam paraqitur edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa, por pa dashur të hyjmë në debat sot e paraqita edhe këtu këtë çështje sepse realisht mendova se kjo do të bëhet sot ngase në mbledhjen e KPF-së kërkuam që në kuadër të pikës të ndryshme në mbledhjen e Kuvendit të debatohet për këtë çështje gjë për të cilën nuk është se u pajtuam aq shumë që të jetë në të ndryshme, por megjithatë ishim në dijeni se do të debatohet sot, ndërsa në këtë mbledhje automatikisht del Drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit dhe propozon pikë të veçantë, e që

nuk ka të drejtë të propozoj, dhe Kryesuesi i Kuvendit mundohet të përfshijë në rend dite edhe këtë pikë të propozuar nga drejtori, kurse e anashkalon një Lagje të tërë e cila vazhdon të trajtohet njësoj që nga paslufta dhe është në gjendje të mjerueshme, pra ka pesë muaj që objektet janë kryer dhe ato familje nuk mund të hyjnë në ato objekte ngase pjesa e përgjegjësisë së Komunës nuk është në nivel të duhur ngase nuk janë kryer obligimet e mara nga Komuna, dje në KPF na është thënë se është në procedurë të prokurimit por unë pyes përse nuk janë kryer më herët ato punë, pra unë këtu e shohë dobësinë dhe nëse vazhdohet kështu, atë Lagje mund ta zë dimri dhe mos të futen ato familje në ato objekte të reja.

Prandaj zotëri Kryesues të definohen gjërat, propozimi i cili bëhet posa fillon mbledhja e Kuvendit pa kaluar fare në KPF, për një Kompani e cila është e ndokujt bënë të hyjë në rend dite ndërsa çështja e cila ka të bëjë me Lagjen e Dëshmorëve sipas juve nuk bënë të hyjë, mendoj se kjo nuk është në rregull. Pra edhe njëherë i drejtohem z. Nexhat Llumnicës, se këtu nuk kemi të bëjmë me politikë.

z. Agim Kikaj, Nënkryetar i Komunës, theksoi, është duke u spekuluar shumë për Lagjen e Dëshmorëve e cila asnjëherë nuk ka qenë Lagje e Dëshmorëve, e them këtë me përgjegjësi të plotë sepse për shkak të përgjegjësisë që kam patur dhe që kam në krye të shumë proceseve që janë brenda atij kompleksi. Fatkeqësia është pajtuar me atë që e thua ti (i drejtohet parafolësit), që nga momenti që është destinuar të bëhet në atë mënyrë. Janë shpenzuar 8 milion e gjysmë marka në atë kohë, ekzistojnë procesverbalet dhe dihet se kush ka kundërshtuar atë formë dhe çfarë kemi kërkuar. Për atë që thuhet se ka probleme në atë Lagje edhe unë pajtohem se ka, por e them se nuk është për të gjitha fajtores as Komuna dhe as Administrata e Komunës, ndërsa lidhur me çështjen e fundit e përmendi edhe drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit se kemi edhe disa procedura dhe disa hapa që janë bërë në relacionin në nivel qendrorë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komuna e Podujevës për ato shtëpi që janë ndërtuar e për të cilat do të zgjidhet kjo çështje por kjo do të përmirësoj gjendjen vetëm për ato shtëpi të cilat janë ndërtuar, mirëpo ne do të duhej të kishim një raport për gjendje e asaj lagjeje në përgjithësi, jo që nuk jemi në dijeni ne për gjendjen e Lagjes por për hirë që të hapim debat për atë çështje, pra nuk kemi të bëjmë me politizim për atë çështje, por e përsërisë, harrojeni se ajo lagje është Lagje e Dëshmorëve ngase më së paku në atë lagje ka familje të Dëshmorëve.

z. Avni Ajeti, theksoi, të nderuar, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit shumë mirë e sqaroi se këtë muaj Komuna do të filloj me punime në atë Lagje, punime të cilat i ka marr si obligim nga Memorandumi i lidhur mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Nga z. Kadri Avdiu, u përmendën disa kërkesa të Shoqatave të dalura nga lufta e për të cilat të gjithë ne besoj se jemi në dijeni se sa janë të politizuara ato Shoqata, gjithashtu jemi në dijeni edhe për pozitën e Kryetarit të atyre Shoqatave i cili me vite është ushtrues detyre, nëse ne e shohim të arsyeshme të diskutojmë pa patur kurrfarë materiali diskutojmë, por unë nuk di se për çfarë të diskutojmë. Pra konsideroj që më mirë është të presim deri sa të përfundojnë procedurat dhe të fillojmë me punë, e them këtë ngase nuk kemi pse të merremi shumë me kërkesa të Shoqatave sepse kërkesa të tilla mund të vijnë të llojllojshme, por nuk mund të thuhet gjëra të ndryshme, ngase ne vihem në pozitë se gjoja nuk jemi për tu kryer punët në atë Lagje, dhe unë jam shumë mirë në

dijeni se si përdoren ato Familje të cilat jetojnë në atë Lagje nga ju (i drejtohet Kadri Avdiut).

z. Nexhat Llumnica, theksoi, e thash më parë se këtë kërkesë e përkrahi dhe duhet të mirëkuptohemi, sa i përket asaj se kjo çështje është e politizuar, tani veç po shihet, shefi i Grupit nga radhët e Vetëvendosjes thotë se është propozim i imi, kurse z. Naim Çunaku thotë se është propozim i PDK-së, pra kjo do të thotë politikë dhe në fakt po shihet qartë se çështja që ka të bëjë me Lagjen e Dëshmorëve është e politizuar dhe imponuar nga partitë politike e parapërgatitur dhe me plan me qëllim që në të ardhmen të dilet para veteranëve të luftës dhe familjeve të dëshmorëve të thuhet se personi NN apo subjekti politik NN nuk votoi për, pra ky është qëllimi i caktuar. Unë jam për të hyrë në rend dite ky propozim.

z. Haki Rudari, theksoi, i nderuari Llumnica kam një pyetje për ju, a e keni vizituar ndonjëherë Lagjen e Dëshmorëve, mendoj se jo, ndërsa ne Grupi i këshilltarëve nga LVV e kemi vizituar me datën 30 qershor të këtij viti. Kërkesa jonë nuk është aspak politike dhe unë nuk u thirra në atë që e thoni ju se gjoja LVV thotë se ne jemi propozues të kësaj pike, urdhëroni ju propozojeni dhe ne do të mbështetim sepse për ne nuk rëndësi kush e propozon por ka rëndësi interesi i qytetarëve jo vetëm sot në këtë mbledhje por në të gjitha mbledhjet, aty ku është interesi i qytetarëve ne e përkrahim, prandaj nuk mund të thuhet se kërkesa e Lëvizjes Vetëvendosje është kërkesë politike, ndërsa a përkrahet nga ju z. Llumnica është çështje e jotja personale.

Do të ndërlihem me diskutimin e Nënkrjetarit të Komunës i cili e tha se ajo lagje nuk është Lagje e Dëshmorëve, për ne nuk ka fare rëndësi se si quhet ajo lagje dhe çfarë lagje është, respekt për të gjithë, mbi të gjitha janë qytetarë aspekt nga i cili jemi nisur ne. Propozimin që e bëre nuk jam duke u munduar të fajësoj Komunën, e kam thënë edhe përpara se aty ku ka debat, vlerë dhe transparencë nuk fajësohet askush, dhe jam në dijeni se Komuna nuk ka shkop magjik që sot ta kryej atë problem, mirëpo Komuna mundet të merr ndonjë veprim emergjent që ata banorë të asaj Lagjeje të kenë ujë 24 orë. Pra kërkesa jonë nuk ka të bëjë aspak me politikë por ka të bëjë me interesin e qytetarëve dhe kërkoj ta votoni sepse është në interes të të gjithëve.

z. Naim Çunaku, theksoi, në diskutimin tim të mëparshëm u mundova të jem i qartë por ndoshta për z. Nexhat Llumnicën nuk kam qenë i qartë, mirëpo për tu qartësuar me këtë dola në foltore, unë nuk thash se është propozim i PDK-së dhe nuk ke nevojë të bësh këso lloj lojërash dhe fjalësh (i drejtohet Nexhat Llumnicës), ndërsa a është apo nuk është kjo çështje e politizuar çdo kush e percepton, akcepton dhe e gjykon me kapacitetin e tij intelektual se a është apo nuk është, por edhe nëse është skajshmërisht e politizuar a duhet që ata banorë të na presin në atë gjendje duke bërë ne politikë këtu, prandaj ne duhet të mundohemi të gjejmë një solucion me dal nga ajo gjendje sepse ndoikujt i ngutet të hiqet nga ato objekte të improvizuara prej llamarine apo kontejner dhe të kalon në një shtëpi me kushte shumë më të mira.

Pa dashur të polemizoj me Nënkrjetarin e Komunës i cili e tha se në atë lagje më së paku ka Lagje e Dëshmorëve, unë them se ajo lagje me vendim të këtij Kuvendi është Lagje e Dëshmorëve sepse kur ka filluar projekti i ndërtimit të shtëpive në atë lagje dhe kur është kërkuar në Kuvend për mbështetje për atë projekt dhe hartimi dhe nënshkrimi i një memorandumi mes Ministrisë përkatëse dhe Komunës së Podujevës, me vendim të Kuvendit të Komunës është ndërruar ky emër nga Lagje e Kuvajtit siç ka qenë është bërë Lagje e Dëshmorëve, pra është për keqardhje nëse ndokush në atë lagje e ka shtëpinë e

përfunduar dhe i duhet vetëm edhe pak kohë për të hyrë në atë shtëpi, pse mos të mundohemi të gjejmë mënyra që sa më shpejt të kryhen punimet dhe të hyjnë ato familje në shtëpi të reja dhe mos të mbesin në kontejner, këtë e them si ndjenjë njerëzore, jo si PDK dhe këtë nuk dëshiroj të përvetësoj ngase mendoj që ai person që mundohet të merr poena në emër të atyre familjeve të cilat janë në atë gjendje, ai për mua është i mjerë, dhe se mendoj se të gjithë ne e kemi vullnetin e mirë për të bërë zgjidhje sa më të shpejtë për ato familje që jetojnë në atë lagje.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, konsideroj se është mirë që paraprakisht të kemi një informatë për Lagjen e Dëshmorëve e pastaj të diskutojmë në një mbledhje të veçantë vetëm me këtë pikë të veçantë të rendit të ditës, ky është propozim i imi.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, propozoj që në këtë mbledhje, në kuadër të pikës të ndryshme të rendit të ditës të kemi nga një informatë të shkurtë për ato çështje të cilat u ngritën dhe njëkohësisht mund të kërkonim që në mbledhjen e ardhshme të përgatitim informatë detaje për të gjitha çështjet që u përmenden. Gjithashtu patëm edhe propozimin e Ekzekutivit të Komunës që e bëri drejtori z. Durim Salihu.

z. Rafet Llapashtica, theksoi, u debatua gjatë për Lagjen e Dëshmorëve, ne të gjithë jemi në dijeni se Kuvendi i Komunës e ka ngritur një komision për atë Lagje, nuk jam në dijeni se deri në cilën fazë ka arritur dhe kush e udhëheqë atë komision. Drejtori z. Faik Muçiqi e tha se me datën 14 të këtij muaji hapen ofertat për instalime të kanalizimit dhe ujësjellësit, por mendoj se është mirë që për këtë pikë për hirë të atyre familjeve të cilat kanë nevoja të veçanta të jetë një rend dite ashtu siç e propozoj edhe këshilltari Fidan Rekaliu. Ne të gjithë jemi për të debatuar për atë Lagje dhe të marrim një vendim konkret në mënyrë që t'jua bëjmë një zgjidhje atyre banorëve të asaj lagjeje sepse mendoj se ka kapacitete për këtë. Është e vërtetë që është politizuar kjo çështje, ka neglizhencë edhe nga Ekzekutivi i Komunës, mendoj se partitë politike të gjitha janë pjesë e familjeve të Dëshmorëve, dikush më pak e dikush më shumë z. Llumnica, dhe të gjithë jemi në dijeni se dikush merret që 13 vite dhe asiston me ndihma sociale në ndonjë familje e dikush vetëm del fol para mikrofonit, pra ka dikush që investon edhe nga pjesa e familjes së vet për të bërë një familje tjetër të ndihet mirë, unë nuk përmendi emra sepse secili e njohim etikën tonë personale, por këtu duhet të dilet me gjëra konkrete, nëse ke bërë ndonjë gjë për atë kategori të qytetarëve është mirë të thuhet.

Lidhur me propozimin e drejtorit z. Durim Salihu, mendoj se është dashur të jetë në Komitet për Politikë dhe Financa, ndërsa këtu sot Kryesuesi e propozon të përfshihet në rend dite për këtë mbledhje, gjë për të cilën mendoj se nuk është në rregull dhe është shkelje, mirëpo nuk ka shumë rëndësi kjo sa ka rëndësi propozimi që t'ia zgjatim kontratën edhe për një vit kompanisë "Pastrimi", kontratë e cila ka qenë njëburimore dhe pa konkurrencë për të zhvilluar më shumë turizëm në liqenin e Batllavës, pra unë personalisht jam kundër këtij vendimi dhe mendoj se i kam arsyet e mia nga ana ligjore e këtij vendimi dhe taksave të parapara, sepse nuk ka konkurrencë, nuk dihet çmimi sa ka marrë kjo kompani, si dhe kam edhe dyshim sepse kjo kompani udhëhiqet nga një zyrtar i LDK-së z. Feim Salihu, pra paraqet tendencë për t'ju vazhduar kjo kontratë, ka edhe shumë element tjerë që ky Kuvend nuk duhet të votoj për këtë propozim, një ndër ato arsye është që Ekzekutivi i Komunës duhet të publikon në fazë tenderuese dhe me konkurrencë të lirë, ndoshta prapë kjo kompani e fiton dhe ne do të jemi ata që do të respektojmë këto taksa, mirëpo Kuvendi duhet të jetë i kujdesshëm për arsye se atëherë duhet të hetohet kontrata e skaduar dhe tendenca e filtrimit për tu paraqitur në Kuvend

kjo dhënie në mirëmbajtje të liqenit të Batllavës të njëjtës kompani edhe për një vit në mënyrë njëburimore, gjë që mendoj se nuk është ligjore, dhe nuk jam në dijeni se në bazë të cilës dispozitë ligjore është thirrur Ekzekutivi i Komunës për të vazhduar këtë kontratë.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë ka kërkesa që propozimet e bëra të hedhen në votim, unë do i hedh në votim së pari propozimin e z. Haki Rudarit që të debatohet në kuadër të rendit të ditës si pikë e veçantë çështja që ka të bëjë me Lagjen e Dëshmorëve, edhe pse ne ishim që të ketë vetëm një informatë të shkurtë në të ndryshme e jo të futet si pikë e veçantë për arsye se nuk kemi material të mjaftueshëm për të debatuar për këtë çështje.

Pas votimit u konstatua se me 16 vota për, 15 vota kundër dhe 2 vota të përmbajtura, miratohet propozimi që të futet në rend dite si pikë e veçantë, çështja që ka të bëjë me situatën e krijuar në Lagjen e Dëshmorëve.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi edhe propozim vendimin për vazhdimin edhe për një vit të dhënien në mirëmbajtje të hapësirës turistike në liqenin e Batllavës kompanisë Pastrimi, propozim i bërë nga Ekzekutivi i Komunës.

Pas votimit u konstatua se me 15 vota për, 16 vota kundër dhe 2 vota të përmbajtura, nuk miratohet ky propozim që të futet në rend dite ky propozim vendim.

Konstatohet se rendi i propozuar i ditës miratohet me një pikë shtesë, përkatësisht,

- **Debat për situatën e krijuar në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc**

2. Miratimi i Ekstraktit të procesverbalit të mbajtur në mbledhjen e Kuvendit më 10 prill 2014

Ekstrakti i procesverbalit miratohet njëzëri

3. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës 2015-2017 **- Qarkorja Buxhetore 2015/1**

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse.

z. Fidan Rekaliu, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit politik LDK, e përkrahim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2015-2017, ngase konsiderojmë se këto projekte realisht do të ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Podujevës, gjithashtu vlerësojmë se këto projekte janë gjithëpërfshirëse dhe të fushave të ndryshme, mirëpo siç e ceku edhe drejtori parafolës, këto projekte nuk janë përfundimtare dhe në rast se ne si këshilltar të Kuvendit të Komunës mendojmë se kemi ndonjë propozim konkret mund të ndryshojmë ndonjë projekt dhe mund të japin ide të ndryshme për ndonjë projekt.

z. Kadri Avdiu, theksoi, Korniza Afatmesme Buxhetore 2015-2017 për ne Grupin e këshilltarëve të PDK-së është e papranueshme duke pasur parasysh se në këtë lëshime dhe vërehet një bartje e mjeteve në pjesë nga vijnë Ekzekutivi i Komunës, ndërsa kemi disa fshatra për të cilat ka katër vite që nuk është paraparë asnjë projekt dhe nuk është investuar fare, parafolësi e tha se ky dokument nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshohet por un them se këto janë vija të cilat janë vënë dhe praktika tregon se asnjëherë nuk është ndryshuar apo plotësuar as nga debatet me qytetarë që ka organizuar Ekzekutivi apo Komiteti për Politik dhe Financa por as nga Kuvendi, do të thot asnjë herë nuk është ndryshuar, pra këto vija janë vënë në këtë dokument në bazë të sistemit politik - partiak, e jo në bazë të rregullës që duhet të përfshihet çdo mes. Ky dokument ka shumë dobësi dhe nuk dua të hyjë në detaje, por dua të përmendi vetëm një argument, të gjithë jemi në dijeni për gjendjen e ujërave të zeza në fshatin Orllan dhe që 14 vite pas luftës dhe po hyjmë në vitin e 17 me këtë dokument që nuk është paraparë asnjë cent për ujërat e zeza në territorin e Orllanit, e mos të flasim për disa fshatra që nuk është ndarë asnjë cent 4 vitet e kaluara dhe nuk është paraparë as për 4 vitet e ardhshme. Grandet jepen në bazë të kokës së banorëve e jo në bazë të parimeve politike.

z. Haki Rudari, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së e kemi shqyrtuar dhe analizuar Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës 2015 – 2017 dhe mendojmë se ky dokument është shumë i rëndësishëm dhe don një trajtim seriozë për arsye se është dokument shumë i rëndësishëm, trajtim të sigurtë sepse shpërndarja e projekteve duhet të bëhet në mënyrë të sigurtë, dhe trajtim shumë profesional për arsye se ka të bëjë me një buxhet mbi 17 milion euro. Këtij materiali i duhet një analizë e detajuar e shpenzimeve publike dhe përcaktim i prioriteteve kryesore për zhvillim të Komunës dhe për rritje të buxhetit dhe mbi të gjitha hartimi i këtij dokumenti është një detyrim për institucionet komunale e cila rregullohet me Qarkoren Buxhetore komunale 2015 - 2017 të lëshuar nga Ministria e Financave.

Ajo që më ka rënë në sy në këtë trajtim që e kam bërë është, të hyrat vetanake nga Komuna e Podujevës, e që kur e kemi analizuar raportin financiar është vërejtur që ka të hyra, përjashtim sektorit që ka të bëjë me tatimin në pronë, ndërsa nëse i vërejmë të hyrat me shifra vërehet se parashihet në vitin 2015 një rritje e të hyrave, ndërsa në realitet kemi zvogëlim të të hyrave komunale. Çështje tjetër të cilën dua të ngris është se nuk vërehen investime në shkollë, edhe pse kjo çështje ndoshta parashihet në investimet e Qeverisë, prandaj kërkoj nga Ekzekutivi i Komunës të parashihet ndërtimi i një shkolle në fshatin Kaçybeg për arsye se nxënësit e atij fshati udhëtojnë mbi 4 km për të arritur te shkollë ku vijnë mësimet, në shkollën e Batllavës, e ku paraqitet një rrezikshmëri e madhe nga rruga e cila shpie për te liqeni i Batllavës. Pra edhe një herë kërkoj të merret parasysh kërkesa që e bëra dhe në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës, Komuna të futë në prioritete ndërtimin e një shkolle në fshatin Kaçybeg.

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, jam munduar të shikoj në detaje këtë Kornizë, në fakt sot nuk dua të elaboroj asgjë rreth kësaj përveç asaj që dua të them se shpresoj se kjo Kornizë është vetëm një dokument të cilin Kuvendi i Komunës ka për obligim ta ketë në rend dite dhe ta diskutoj si dhe shpresoj që Komuna jonë në këto tri vite nuk do të punoj në bazë të kësaj Kornize sepse kjo kornizë nuk i ofron zhvillim Komunës së Podujevës, por vetëm e mban një gjendje që aktualisht është, dhe nuk jemi më në gjendje emergjente por jemi në një fazë zhvillimore. Prandaj unë mendoj se si e tillë kjo Kornizë nuk duhet të aprovohet.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, me të vërtetë më pëlqeu ideja kur u tha nga një parafolës se ka vend për ide dhe për propozime dhe sugjerime për këtë Kornizë Afatmesme Buxhetore. Unë propozoj që të zvogëlohen shpenzimet për mallra dhe shpenzime dhe shpenzimet e komunalive si dhe buxheti i disa infrastrukturave tjera të shpenzohet për subvencione në bujqësi, e them këtë ngase kemi shumë vende ku ekziston rruga, ambulanta, shkolla etj, por nuk ka banorë në ato vende, pra dua të them se nëse ata njerëz subvencionohen në lëmi të ndryshme do të krijoheshin vende të reja të punës dhe do të mundësohej kthimi i atyre banorëve në ato vende.

z. Nexhmi Rudari, drejtor i Drejtorisë së Arsimit, theksoi, jam në dijeni se të gjithë ne që jemi këtu jemi të interesuar dhe kemi dëshirë të përmirësojmë infrastrukturën fizike, shkollore apo atë në përgjithësi, mirëpo sa i përket ndërtimit të shkollave të reja në fshatra, lagje apo edhe në pjesë të qytetit duhet të bëhet analizë më e thuktë se sa është progresioni i rritjes së fëmijëve gjegjësisht i nxënësve në ato mese apo numri i tyre është duke rënë. Drejtorja e Arsimit e Komunës së Podujevës është duke u ballafaquar vërtetë me një shqetësim të madh kohëve të fundit, konkretisht edhe këtë vit, me rënien bukur të madhe të numrit të nxënësve, gjë e cila do të ketë pasoja të shumfishta në zvogëlimin e vendeve të punës, sepse nëse nuk ka nxënës nuk mund të ketë norma. Sa i përket fshatit Kaçybeg që e ngriti parafolësi, ai fshat ka herë ka pasur kërkesë për ndërtim të një shkolle fillore, deri në klasën e pestë, në atë fshat, mirëpo megjithatë numri i nxënësve nuk e arsyeton atë, pastaj çështja tjetër është transporti i nxënësve e cila është e rregulluar me Udhëzime Administrative ku dihet se nëse nxënësi duhet të udhëtoj mbi 4 km në njërën anë, Komuna gjegjësisht Drejtorja e Arsimit është e obliguar të siguroj transportin pa pagesë për ata nxënës, gjë të cilën jemi duke e bërë. Çështja tjetër ka të bëjë me grandin specifik të Arsimit, gjë të cilën e kam thënë edhe më parë se Ministra e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë në kundërshtim me ligjin është duke e mbajtur buxhetin për investime kapitale dhe duke menaxhuar me atë buxhet, është në kundërshtim me ligjin sepse në bazë të formulës së financimit komunave është dashur që nga viti 2008 t'ua transferoj buxhetin për investime kapitale konform formulës së financimit që është 7 € për kokë të nxënësit, dhe po që të respektohej kjo ne në Komunën e Podujevës do të kishim afërsisht rreth 1 milion e gjysmë euro për investime kapitale vetëm në Drejtorinë e Arsimit, kurse ne në këtë vit i kemi 235,000.00 €. Tani ne bëjmë kërkesa edhe për lagje dhe gjithsesi ne do t'i shqyrtojmë ato dhe do t'i dërgojmë në Ministrinë përkatëse me të cilat do të kërkojmë buxhet për vitin 2015, mirëpo e përsëris se duhet që seriozisht të merremi me të dhëna dhe statistika se a ka jetëgjatësi ajo shkollë sepse ka ndodhur që në Kosovë pas luftës janë ndërtuar me dhjetëra dhjetëra shkolla të reja nëpër fshatra dhe tani nuk e kanë asnjë nxënëse.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, dëshiroj të ju njoftoj se ne një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kemi shqyrtuar këtë pikë dhe i kemi rekomanduar Kuvendit me dy ndryshime, i pari ishte, të rritet buxheti i Kuvendit të Komunës në kategorinë mallra dhe shërbime, dhe ndryshimi i dytë ishte, projekti për asfaltimin e rrugës në fshatin Revuç i paraparë për vitin 2016 të bartet në vitin 2015.

Me siguri se jeni në dijeni se në mandatin e kaluar kam qenë drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit dhe mund të them lirshëm se të gjitha rrugët kryesore të fshatrave në territorin e Komunës së Podujevës janë asfaltuar, kan mbetur vetëm disa rrugica nëpër disa lagje dhe besoj se brenda dy viteve edhe këto do të

përfundohen e pastaj mund të kalojmë në fazën që e përmendi z. Lutfi Rexhepi që ka të bëjë me zhvillim ekonomik dhe subvencione etj.

Korniza Afatmesme Buxhetore është obligim ligjor për komunat që ta miratojnë në afat të caktuar nga Ministria përkatëse, andaj mosmiratimi i këtij dokumenti nga komunat do të kishte edhe sanksione për ato komuna. Gjithashtu ne jemi dakord që vërejtjet, plotësimet dhe sugjerimet t'i marrim parasysh për të cilat kemi afat deri më 30 shtator të këtij viti, dua të them se kemi kohë edhe dy muaj që të gjitha propozimet e arsyeshme që bëhen do të shqyrtohen. Andaj me këto vërejtje që u dhanë, e hedh në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore të Komunës së Podujevës, 2015 – 2017.

Pas votimit u konstatua se me 16 vota për, 15 vota kundër dhe 1 votë të përmbajtur, u miratua Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Podujevës, 2015 - 2017

4. Propozimi i vendimit për miratimin e Planit Komunal për Eficiencë të Energjisë, për periudhën 2014 – 2020

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratua ky propozim vendim

5. Debat për situatën e krijuar në Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc

z. Faik Muçiqi, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, theksoi, e mirëpresim debatin për këtë çështje edhe pse plotësisht nuk jeni të përgatitur me materiale, unë e thash se një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa i kemi diskutuar të gjitha dhe kemi qenë të qartë të gjithë, mirëpo po i kthehemi edhe njëherë kësaj teme dhe besoj se është në interes të të gjithëve të sqarohemi sa më shumë për këtë çështje.

Në memorandumin e nënshkruar mes Komunës së Podujevës dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Komuna ndër të tjera obligohet që të kryej infrastrukturën përcjellëse publike, siç janë rrugët, trotualet, ujësjellësi, kanalizimi dhe kycja në rrjetin energjetik.

Posa kam marrë pëlqimin për zhvillimin e procedurave të prokurimit për një pjesë, e them për një pjesë sepse Lagja e Dëshmorëve i ka mbi 130 shtëpi, meqenëse në fazën e parë janë ndërtuar 30 shtëpi dhe projekti i hartuesit të Komunës ka qenë projekt i përgjithshëm, pastaj kur kemi filluar infrastrukturën përcjellëse na është dashur të kemi një projekt zbatues për 30 shtëpi, projekt i cili na është dorëzuar me një vonesë bukur të gjatë. Më datë 12.05.2014 është proceduar në prokurim, mirëpo pas 20 ditësh është kërkuar të ndryshohet paramasa e projektit zbatues për segmentet e ujësjellësit, kanalizimit dhe një pjese të kycjeve energjetike, dhe në harmoni me projektin që janë ndërtuar shtëpitë i kemi proceduar në prokurim dhe kemi kërkuar procedurë të përsheptuar ku për fat të keq nuk ka mundur të shkoj me procedurë të përsheptuar për arsye se vlera e përgjithshme e këtyre tri infrastrukturave kalon shumë mbi 10,000.00 €, ndërsa tani jemi në fazën e marrjes së ofertave nga operatorët ekonomik, kemi shumë të interesuar dhe me datën 14 korrik është hapja ligjore e procedurës së tenderimit, pra fjala është për 30 shtëpi.

Unë e kam pranuar nga Kryesuesi i Kuvendit shkresën e Shoqatave të dalura nga lufta, duke mos hyrë në analizë të kësaj shkrese mendoj se është qëllim mirë, por duke përjashtuar fjalinë e fundit ku thuhet se do të detyrohem të protestojmë po që se Kuvendi i Komunës nuk e miraton këtë kërkesë, në këtë kontekst unë them se Kuvendi nuk e miraton memorandumin dhe kjo kërkesë ka të bëjë me diçka që parashihet në memorandum, procedurat e tenderimit janë të qarta, prandaj Kuvendi nuk ka nevojë të miratoj tani diçka që do të ishte mbi memorandumin, sepse askush nuk e ka kontestuar memorandumin e nënshkruar nga Kryetari i Komunës dhe ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Është fakt që ka vonesa por ato janë të kompleksit të vetë Lagjes së ndërtimit sepse ka filluar edhe ndërtimi i 20 shtëpive tjera sipas memorandumit, shënon se nuk mund të fillohen mirëpo është e vërtetë se është siguruar lokacioni, janë duke u ndërtuar edhe 20 shtëpi dhe nuk ka pengesa dhe nuk është pengesë as infrastruktura e mëhershme për të vazhduar punimet, dhe së dyti jeni në dijeni se në mbledhjen e mëparshme Kuvendi e ka miratuar një Rregullore për ndarjen e atyre shtëpive, pa të cilën edhe po të ishin të tëra ato shtëpi në gjendje të banueshme, caktimi i atyre familjeve që do të hynin në atë shtëpi do të ishte i pamundur. Konsideroj se edhe punën e komisionit të ngritur nga Kuvendi për ndarjen e atyre shtëpive nuk e pengon infrastruktura përcjellëse dhe shpresoj se deri sa të ndahen ato shtëpi infrastruktura do të jetë e gatshme për 30 shtëpitë e para. Pra ne e morëm si pikë referuese për të diskutuar kërkesën e Shoqatave por jo për të debatuar për gjithë Lagjen e Dëshmorëve. Por nëse diskutojmë për problemin e ujit të cilin e përmendi z. Haki Rudari, kanalizimit, mbeturinave, rrymës etj, atëherë neve na duhen shumë informacione nga disa Drejtori tjera gjë që do të mundësonte një debat më të gjerë. Pra edhe një herë sot i referohemi kërkesës së Shoqatave të dalura nga lufta dhe japim informata për ju që të mos të ketë dhe mos të përcjellën dilema në opinionin publik për gjoja se Komuna apo Kuvendi i Komunës është kundër apo i neglizhon gjërat.

Pra gjendja është kjo, jemi në procedurë të prokurimit dhe nuk mund të ndërhyjmë që të përshpejtojmë apo të ndryshojmë diçka nga ajo, por besoj se nga 14 korriku presim operatorin i cili do t'i kryen punët e para dhe dinamika e punëve është maksimale 15 ditë, që do të ketë afër 300 m kanalizim, mbi 300 m ujësjellës, afër 500 m kycje energjetike, ndriçimet e brendshme, ndërsa pjesët tjera nga memorandumit nuk mund të kryhen tani si, trotuari, gjelbërimi, asfaltimi sepse ato do të kryhen kur të kompletohet kompleksi ngase ato pengojnë njëra tjetrën.

z. Haki Rudari, theksoi, konsideroj se gjendja e rëndë në Lagjen e Dëshmorëve realisht nuk është vetëm që nga vizita që kemi bërë ne si LVV, por kjo gjendje mbretëron që nga themelimi i asaj Lagjeje, gjithashtu mendoj se sikur të bëhej ndonjë debat më i madh më parë sigurisht që gjendja do të përmirësohej, sa për informatë Komuna e Gjilanit dy ditë më parë ka mbajtur një mbledhje të jashtëzakonshme për mësimdhënës, prandaj mendoj se edhe ne do të ishte mirë që për Lagjen e Dëshmorëve të mbajmë një mbledhje të jashtëzakonshme, është mirë që tani po debatojmë për këtë dhe nuk dëshiroj të politizoj por dua t'i kthehem gjendjes faktike që është në atë Lagje, po e përsërisë se ka mungesë të ujit, mungesë të higjienës në tërësi, mungesë dhe probleme infrastrukturore, andaj kur t'i marrësh për bazë të gjitha këto mund të vijmë në përfundim se së paku kemi mundur të bëjmë diçka më shumë për atë Lagje në mënyrë që gjendja e tyre pak a shumë të përmirësohej. Drejtori parafolës e përmendi prokurimin dhe unë si anëtar i komisionit për ndarjen e shtëpive në atë Lagje plotësisht po pajtohem se është dashur të mblidhemi dhe

të fillojmë me punë për ndarjen e atyre shtëpive në atë Lagje sepse nuk kemi pengesë, megjithatë këtu ka pasur neglizhencë nga zyrtari i Komunës z. Ruzhdi Dema i cili është pjesë e komisionit nga i cili asnjëherë nuk na është ofruar material dhe asnjëherë nuk na ka kontaktuar që të debatojmë, z. Avni Ajeti, si kryesues i Komisioni në mbledhjen e fundit ka kërkuar që kjo çështje të përshpejtohet, gjë që ka pasur përkrahjen time personale. Unë jam në dijeni se nuk kemi material të mjaftueshëm për këtë çështje, mirëpo vetë fakti që ne po debatojmë për këtë çështje mendoj se është një shenjë e mirë për ata qytetarë, prandaj unë si sponsorues i kësaj pike, propozoj që në mbledhjen e ardhshme Drejtoritë përgjegjëse të bëjnë një raport më të plotë dhe më të detajuar për gjendjen e banorëve në Lagjen e Dëshmorëve dhe të na dorëzojnë në Kuvend, dhe propozoj që të gjitha Grupet e këshilltarëve të Kuvendit t'a vizitojnë atë Lagje, dhe me siguri se do të binden se vërtetë është gjendje e rëndë atje dhe pres që raportin që e kërkoja nga Drejtoritë do të jetë më detajuar.

z. Kadri Avdiu, theksoi, kjo pikë hyri si pikë e veçantë e rendit të ditës dhe a po e shihni të nderuar këshilltarë të Kuvendit dhe Ekzekutiv i Komunës se nuk ndodhi asgjë e jashtëzakonshme, andaj për tema të cilat ka nevojë të diskutohet përse bëhet gjithë ky ngujim dhe kjo ngufatje dhe përse frikohet ndokush nga këto tema. Në fillim të kësaj mbledhjeje u tentua të politizohej kjo çështje dhe unë edhe pse jam shef i Grupit të këshilltarëve të PDK-së në këtë rast flas në emrin tim personal, ndoshta për herë të parë, se edhe unë jam pjesë e familjeve të Dëshmorëve dhe nuk dua asnjëherë të shfrytëzoj këtë pjesë, flas në kuptimin që mund të ketë ndokush se kjo shfrytëzohet, por sido që të jetë kjo është çështje e personave të caktuar që unë s'dua të merrem me këtë, mirëpo qëllimi i kësaj çështjeje është diskutuar edhe në mbledhjet e mëparshme dhe pikërisht në mbledhjen e kaluar kemi kërkuar që të përshpejtohen procedurat, pra nuk diskutohet sot vetëm pse ka kërkesë nga Shoqatat e dalura nga lufta, por në momentin që ka ardhur edhe një kërcënim nga Shoqatat e dalura nga lufta, ne bëmë atë presion që kjo çështje të futet sot në rend dite për arsye që mos kemi një situatë të përshkallëzuar, pra qëllimi ka qenë ky dhe nuk ka pasur fare të bëjë me atë se kush më shumë e kush më pak e mbronë atë, të kuptohemi se ato janë familje tona dhe për fat të keq këtu i akuzoj edhe institucionet Qendrore edhe Lokale sepse ka 14 vite dhe është dashur që dikujt t'i bie ndërmend dhe të merret me ato familje, ndërsa në komuna tjera kanë përfunduar kto gjana shumë më herët, ndërsa tani dikujt i ka rënë ndërmend dhe është marrë me këtë problem përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, mirëpo lëshimet e Ekzekutivit të Komunës sonë dhe mos interferimi nga ana e saj se herë e njohim e herë nuk e njohim, por kur kemi të bëjmë me interesin e qytetarëve nuk duhet t'i shikojmë ato gjëra, pra krejt çka dua të them është se të bëhemi seriozë në punë, kjo vlen për Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, se kur po iu duhen punë të ngutshme Ekzekutivit prokurimet po kryhen shumë shpejt, ndërsa kur kemi të bëjmë me një çështje shumë të rëndësishme, siç është kjo pikë, krejt treva e Llapit e merr vesh se ka procedura të prokurimit, ne kemi kërkuar edhe muajin e kaluar dhe nuk është bërë asgjë, vetëm shtyhet dhe nuk ndërmerret asgjë ndërsa frika mbetet se do të hyjmë në stinën e dimrit dhe nuk do të bëhet asgjë. U tha se komisioni mund të fillon me punë për ndarje të 30 shtëpive, unë konsideroj se komisioni përkatës nuk mund të filloj me punë për arsye se përderisa nuk kryhen të gjitha punët ato shtëpi nuk mund të pranohen sepse nuk ka rrymë, kanalizim dhe nuk ka ujë. Pra mundohen të hedhin fajësinë diku tjetër kur vetë nuk i kryejnë punët, pastaj nga Ministria përkatëse fillohen edhe 20 shtëpi tjera pa u

përfunduar këto, mirë që kanë filluar edhe 20 shtëpi tjera të ndërtohen, mirëpo sipas informatave që kam duhet të pozicionohen së pari këto 30 familje për tu liruar vendet për ndërtimin e shtëpive tjera, do të thotë duhet të hiqen ata kontejner për t'iu liruar vendi ndërtimit të shtëpive, andaj të mos vijmë në një situatë që ndoshta për shkak moskryerjes së obligimeve nga Komunës të mos fillohet me ndërtimin e 50 shtëpive në vitin e ardhshëm. Pra të nderuar, ne këshilltarët e Kuvendit jemi këtu vetëm për të mbrojtur interesat e qytetarëve pavarësisht se cilës Lagje i takojnë ata qytetarë dhe kjo ishte arsyeja që të debatohet për këtë çështje, dhe po e shfrytëzoj këtë diskutim dhe po e përmendi rastin e Obeliskut Afrim Zhitia ku Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë që tre muaj e neglizhon verifikimin e pronës, prandaj me këtë fakt lenë vend për dyshime për çështje tjera, sepse vonohen gjërat me qëllim duke u arsyetuar në Agjencionin Kadastral të Kosovës, dhe për çështje të tilla ne këshilltarët e Kuvendit domosdo duhet të ngritim zërin me qëllim të ndryshimit nga negativja në pozitive.

z. Fidan Rekalio, theksoi, mendoj se askush nuk është kundër debatit për Lagjen e Dëshmorëve në fshatin Balloc dhe besoj se të gjithë jemi për të bërë një zgjidhje në atë Lagje e cila me të vërtetë është në një gjendje shumë të rëndë, mirëpo unë e thash edhe në fillim që jam i mendimit se është mirë të përgatitemi dhe të kemi më shumë material rreth Lagjes dhe të diskutojmë një pikë të veçantë, pra edhe një herë po e them se ne nuk jemi kundër debatit dhe çdo herë kemi qenë pro debatit dhe vazhdojmë të jemi pro debatit për çfarëdo çështjesh, por për këtë çështje konsideroj se më e rëndësishme do të ishte sikur ne të kishim një informatë dhe të diskutojmë më gjerësisht për atë informatë.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, me të vërtetë Lagjia e Dëshmorëve ka vuajtur shumë sepse ka pasur mungesë të energjisë elektrike në stinën e dimrit, ka pasur edhe mungesë të ujit etj. andaj mos t'i lëmë të vuajnë edhe më tutje por të ndërtohet infrastruktura sa më shpejt që është e mundur sepse janë ndërtuar 30 shtëpi dhe vetëm pritet rregullimi i infrastrukturës që ato shtëpi të bëhen me banorë të cilët kanë nevojë. Për faktin që unë për këto gjëra dhe rrethana jam në dijeni tregon qartë që unë kam vizituar familjet e Dëshmorëve, i nderuari Haki Rudari, dhe nuk është e rëndësishme të shkosh te varret e tyre por është e rëndësishme të ecësh rrugës së tyre. Unë jam pjesë e familjeve të Dëshmorëve dhe kam qenë bashkë me ata persona që kanë rënë Dëshmorë, andaj nuk mund të thuash se ne nuk i vizitojmë familjet e Dëshmorëve, ndoshta ne nuk i vizitojmë atëherë kur ju dilni para televizioneve gjoja se keni bërë diçka.

z. Haki Rudari, theksoi, rreth asaj se kush dhe sa ka kontribuar i nderuari Llumnica kur të dëshironi ju mund të më ftoni në ndonjë emision në Radio Vizion apo Radio Llap dhe aty mund të matim kontributin unë dhe ti. Unë vijë nga lufta dhe vetë kam qenë pjesë e luftës me gjithë vëllain tim, dhe në vitin 1998 jam bastisur si familje, bastisje e cilës ka qenë e para në Komunën e Llapit, për këtë më vie keq nga të tjerët por më duhet ta sqaroj i nderuar (i drejtohet Nexhat Llumnicës), unë nuk kam qenë kundër asaj, megjithatë ato që ti i thua ndoshta ti i ke bërë në fushat, por unë kam vizituar atë Lagje më 30.06.2014 dhe në këtë datë nuk ka pasur fushat zgjedhore më duket, nëse kthehemi mbrapa ne e dimë fushatën që ti ke bërë dhe vërejtjet që ti iu ke bërë njerëzve kurse në një far mënyre prapë je bërë me ata persona, por t'i lejmë këto dhe mos të hyjmë në këtë temë, sepse secili prej nesh e ka kontributin e vet dhe kapitalin e vet.

z. Nexhat Llumnica, theksoi, po i drejtohem parafolësit, i nderuar nuk e kontestoj askush se ti nuk ke qenë pjesë e luftës, por unë e thash atë që e the ti, andaj unë nuk e kontestova dhe të përuroj dhe të përgëzoj për kontributin që e ke dhënë në luftë, mirëpo nuk mund të thuash se nuk japin edhe të tjerët kontribut sot.

z. Naim Çunaku, theksoi, rreth kësaj çështjeje më shumë u harxhua energji se a do të hynë në rend dite për këtë mbledhje se sa që tani është duke u debatuar për këtë temë.

Në një formë ka qenë i shtyrë Kuvendi i Komunës për të debatuar sot për këtë çështje duke i marr parasysh shkresat e Shoqatave të dalura nga lufta dhe e pamë se si hyri në rend dite kjo çështje gjë që nuk mendoj se u bë diçka e keqe që kjo çështje hyri në rend dite, mirëpo nuk di sa ne po dalim të sqaruar pas këtij debati, dhe për këtë shtrohet pyetja, a po dalim ne më të sqaruar apo do të kemi të njëjtin konfuzitet, me përjashtim të disa llafeve mes këshilltarëve. Sa për kureshtje apo interesim timin personal, unë drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit e kam dëgjuar edhe një ditë më parë në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe pa dashur të hyjë në atë se pse ka ndodhur kjo vonesë në kryerjen e infrastrukturës përcjellëse në Lagjen e Dëshmorëve dhe pa dashur të fajësoj drejtorin, por duke menduar se faji i dikujt është që kjo vonesë ka ndodhur mirëpo shpresoj se është mirë që është në rrugë të drejtë të zgjidhjes së kësaj çështjeje, dhe nga diskutimi i drejtorit na del që më 14 qershor 2014 do të hapen ofertat dhe operatori i cili do të fitoj projektin do t'i duhen rreth 15 ditë që t'i përfundoj punimet. Diçka që jam i interesuar të di dhe që nuk dëgjova deri më tani është se nuk dëgjova asgjë nga komisioni i ngritur nga ky Kuvend për përzgjedhjen e përfituesve të shtëpive në Lagjen e Dëshmorëve dhe kërkoj që dikush nga komisioni të na informoj apo të na tregoj se deri në cilën fazë kanë shkuar ky komision në punën apo aktivitetet e tyre si komision dhe a janë afër përzgjedhjes së përfituesve të shtëpive, e them këtë ngase edhe drejtori z. Muçiqi e tha se ndoshta do të kishte qen mirë që komisioni ta kryej punën e tij, dhe të kemi parasysh se sikur tani që na paraqiten probleme me siguri se do të na paraqiten edhe pasi të bëhet përzgjedhja ngase me siguri se do të bëhen ankimime në ato vendime. Pra sipas asaj që u tha punët teknike do të kryhen brenda 1 muaji, andaj dëshiroj të di se a është i gatshëm komisioni përkatës që për 1 muaj t'i kenë të kryera edhe vendime edhe afatin kohor të ankimimeve, e them këtë me qëllim që të mos ndodh që të presim edhe pasi të jenë komplet të rregulluara ato shtëpi.

z. Bahri Selimi, theksoi, u than të gjitha rreth kësaj çështjeje por një gjë më bëri përshtypje se të gjithë ne në këtë Kuvend jemi pro debatit, mirëpo përse nuk kemi vepruar kështu deri më sot në lidhje me këtë çështje. Fillimisht u hezitua mjaftë shumë që kjo çështje të hyjë në rend dite, por unë nuk mendoj se këtu ka diçka të keqe që ne debatuar për Lagjen e Dëshmorëve, gjithashtu u përmend se sa ne po dalim të sqaruar nga ky debat, mendoj se vetë debati është sqarim, ne faktikisht kemi kërkuar të sqarohemi se si ka shkuar puna dhe si janë zhvilluar gjërat deri më sot në atë Lagje, prandaj ne nga ky debat kuptuam nga drejtori z. Faik Muçiqi për rrjedhën e punimeve apo procedurave dhe çka duhet të bëhet në të ardhmen, pra debati ishte konstruktiv, sqarimi u bë, por më e rëndësishmja mbetet pse ka vetëm debat e nuk ka edhe veprim.

z. Kadri Avdiu, theksoi, meqë u kërkuar një informatë nga komisioni për ndarjen e shtëpive se deri në cilën fazë ka shkuar puna e tij unë mora fjalën që të japë një informim të shkurtër rreth kësaj, komisioni është takuar dhe unë si pjesë e atij komisioni mendoj se mund të kryejmë punën tonë për një muaj, mirëpo deri më tani nuk kemi pasur kurrfarë

informatash dhe nuk kemi pasur afat se deri kur mund t'i kryej punët Ekzekutivi i Komunës, prandaj nuk kemi pasur mundësi të ndërmarrim asgjë rreth kësaj çështjeje.

Tani ne e kemi një konkluzion që doli nga ky debat që Ekzekutivi i Komunës përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit u zotua që brenda afatit përkatës do të kryej punët e vetë e pastaj do të mbetet kompetencë dhe përgjegjësi e komisionit.

z. Avni Ajeti, theksoi, ne si komision për ndarjen e shtëpive në lagjen e Dëshmorëve kemi mbajtur një mbledhje, andaj pyes z. Kadri Avdiun, pse ka munguar në atë mbledhje.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, para se të hynte kjo pikë si pikë e veçantë e rendit të ditës unë insistova që të kemi vetëm një informatë gjë e cila nuk do të kishte kurrfarë problemi të bëhej vetëm si informatë, ngase po të kishim material të përgatitur edhe debati edhe informimi mund të ishte më i kompletuar, mirëpo debati u bë dhe tani e përfundojmë këtë pikë me konkluzion, që të respektohen afatet e procedurave të tenderimit dhe të fillohen punimet e ndërtimit të infrastrukturës përcjellëse në afatin sa më të shkurtër menjëherë pas shpalljes së operatorit fitues.

6. Të ndryshme

z. Lutfi Rexhepi, theksoi, çështjen të cilën e ngrita më parë e bëra me qëllim t'ju njoftoj se unë konsideroj se vërtetë vie në pikëpyetje vazhdimi i punës së komisionit për propozimin e emërtimeve të zonave, lagjeve urbane, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës, pra e shtrova këtë ngase puna e komisionit nuk do të vazhdoj ngase bazohem në disponimin e shumicës së kolegëve të mi, pra nuk është punë e imja që të insistoj këtu unë për këtë gjë por vetëm desha t'ju njoftoj. Çështje tjetër që dëshiroj të them është se në mbledhjen e kaluar unë i kam shtruar dy pyetje dhe kam kërkuar dy përgjigje prej Ekzekutivit të Komunës të cilat nuk i kam marrë, pra unë qëndroj prapë pran atyre kërkesave dhe kërkoj prej Drejtorive gjegjëse që të më ofrojnë ato përgjigje që i kam kërkuar, për të cilat fundja e kanë edhe obligim ligjor.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me çështjen e parë që ka të bëjë me kompensimin e anëtarëve të komisionit për propozimin emërtimeve të zonave, lagjeve urbane, shesheve, parqeve, rrugëve dhe rrugicave në territorin e Komunës së Podujevës, unë kam biseduar për këtë çështje edhe me Kryetarin e Komunës, vullneti për kompensim nuk mungon por kemi ende punë dhe nuk kemi arritur ende të kryejmë as gjysmën e punës, kompensimi – pagesa për anëtarët e komisionit do të bëhet por vetëm ka mbetur të shikojmë edhe praktika të Komunave tjera se në çfarë forme e kanë bërë këtë kompensim, Kryetari i Komunës e ka autorizuar drejtorin e Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave që të gjejë formë për të kompensuar këtë komision. Ndërsa sa i përket pyetjeve që i ke bërë besoj se përgjigjet do t'i marrësh në një nga mbledhjet e radhës.

Mbledhja përfundoi në orën 14;50

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr. 01-006-60120
Podujevë,
2 korrik 2014

Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi